



Prishtine, data: 01.07.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 384 dt. 13.02.2013 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **Pajtim Jashari** person fizik, me adresë; Zhilivodë, Vushtri, merr këtë vendim :

AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtrësive për **Pajtim Jashari** person fizik, me adresë; Zhilivodë, Vushtri, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsyetim

Ndaj **Pajtim Jashari** person fizik, me adresë; Zhilivodë, Vushtri, KPMM ka leshuar aktin administrativ me nr. 384 dt. 13.02.2013.


Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt. 13.02.2013 dhe me dt.02.07.2018 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .


Ramiz Krasniqi

Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale





Prishtinë, 11.02.2013/12


Në pajtim me nenin 79 paragrafet 3,4 dhe 5 të ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale,
 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerre këtë:

AKTVENDIM

Ndaj Pajtim Jashari person fizik me nr. të telefonit 049/287062, me adresë; fshati Zhilivod,
 Komuna e Vushtrisë.

1. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 3 shqiptohet gjoja administrative për shfrytezimin e resurseve minerare e cila është e barabarte me trefishin e shumës së rentave minerare të cilat duhet të paguhet për mineralet e shfrytëzuar ose eksploatuar e cila është **2,706.13€**
2. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjoja administrative për shfrytezim ilegal në shumë prej **5,000.00€**
3. Dhe në pajtim me nenin 79 paragrafi 5 shqiptohet gjoja administrative në mënyrë kumulative (grumbulluese) lidhur me paragrafet 3 dhe 4 të këtij neni e cila është në shumën e përgjithshme prej **7,706.13€**

Arsyetim



Gjatë inspektimit të operimeve ilegale me datën 09.11.2012, personi fizik Pajtim Jashari është hasur duke operuar ilegalisht në shfrytëzimin e resurseve minerale. Shfrytëzimi i resurseve minerare është bërë në lokacionin që gjendet fshatin Zhilivod komuna e Vushtrisë. Inspektorët e Minierave kanë konstatuar se ju keni ushtruar aktivitet të paligjshëm pa u pajisur me Licencë të Shfrytëzimit. Lloji i mineralit që ju shfrytëzonit ishte Qymyr.

Ju jeni udhëruar me anë të urdhëresës për ndërprerje të aktivitetit ilegal të lëshuar nga Inspektorët në datën e inspektimit që menjëher të ndërprej aktivitetin e paligjshëm.

Inspektorët e Minierave kanë konstatuar se Pajtim Jashari aktivitetin e operimeve ilegale e bënte në lokacionin me keto koordinata: Y= 7499475, 7499492, 7499479; X= 4729696, 4729709, 4729720; Z= 599, 596, 595, për të cilat koordinata nuk keni poseduar Licencë për Shfrytëzimin e mineraleve të Qymyrit.

Me datën 10.12.2012, Departamenti i Gjeodezisë në KPMM-së ka kryer matjet gjeodezike në fushën e shfrytëzimit e cila sasi e shfrytëzuar e mineralit të Qymyrit është prej **3,154.00.m3**

Afati për kryerjen e pagesaës së gjobës administrative është 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pagesa e faturës bëhet në Bankën Qendrore të Kosovës në këtë xhirrollogari 1000430070005950.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.


Aktvendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori i KPMM

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit për Ankesa të KPMM.

Sipas nenit 128.2 të Ligjit për Procedurën Administrative, ankimi administrativ nuk e pezullon zbatimin e aktvendimit, sepse aktvendimi synon mbledhjen e taksave, tatimeve ose të ardhurave të tjera buxhetore.

Aktvendimi t'i dergohet:

Arkivesë së KPMM-së,
Departamentit të Financave të KPMM-së,
Palës


Midir Bojaxhiu
Drejtor
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale